



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 29, Datë 22.02.2024

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 306, DATË 23.10.2023,
“PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE SHOQËRISË “DRAGOBIA ENERGY”
SH.P.K., PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE
SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016: Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.02.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 575/1 prot., datë 15.02.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 23.10.2023, për dhënien e autorizimit nga ERE shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut që kontrollon intereset e saj”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 306, datë 23.10.2023 vendosi:
- 1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e asetëve të Fikse (nëpërmjet hipotekimit), në favor të BANKËS AMERIKANE TË INVESTIMEVE sh.a., BANKËS SË TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a. (Lista e asetëve bashkëlidhur).
- 2. Shoqëria duhet të dorëzojë kontratën finale të nënshkruar, ku të përfshihet vullneti i bankave (BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE sh.a., BANKA E TIRANËS sh.a. dhe UNION BANK sh.a.) mbi gatishmërinë për të garantuar veprimtarinë e licencuar në rastin e kryerjes së transferimit, si pjesë përbërëse të saj.
- 3. Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin nëpërmjet hipotekimit të asetëve të paluajtshme të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta, në rast se do të ndodhi transferimi i këtyre asetëve nëse kjo kërkohet.
- 4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kudër të kushteve të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi.

- ERE me shkresën nr. 2048/11 prot., datë 02.11.2023 njoftoi shoqërinë mbi vendimin e marrë nga bordi, si dhe i solli në vëmendje depozitimin e dokumentacionit lënë kusht në vendim.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 575 prot., datë 05.02.2024 në kuadër të plotësimit të kushtit të lënë nga ERE, ka depozituar Kontratën e Kredisë Bankare me nr. 6098 Rep., nr. 2926 Kol, datë 14.10.2023, si dhe Akt Marrëveshjen me nr. 6097 Rep, nr. 2925 Kol, datë 14.10.2023.
- Subjekti gjithashtu ka përcjellë deklaratën noteriale me nr. 644 Rep., nr. 362 Kol., datë 02.02.2024 të nënshkruar nga të tre bankat kredidhënëse (Banka Amerikane e Investimeve sha, Banka e Tiranës sha dhe Union Bank sh.a.), *ku deklarohet se bankat kredidhënëse garantojnë angazhimin e plotë për vazhdimësinë e veprimtarisë së licencuar në rastin e kryerjes së transferimit të asetëve fikse të shoqërisë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k., si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve të rrjedhura nga kontrata e kredisë.*
- Me depozitimin e dokumentacionit si më sipër cituar, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2, si e tillë nuk gjen më zbatim as pika 4 e vendimit të bordit nr. 306/2023, ndaj vlerësohet që pika 2 dhe 4 të shfuqizohen.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 dhe 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 306, datë 23.10.2023, shfuqizohen.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DRAGOBIA ENERGY” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI